



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**RAPORT
MBI
MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE,
PËR 4 -MUJORIN E PARË TË VITIT 2026,
PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT**

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje
2.	Raporti i shpenzimeve faktike për vitin 2026.....
2.1	Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit
	Analiza financiare analitike
2.1.1	Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)
2.1.2	Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)
2.1.3	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)
2.1.4	Shpenzimet kapitale (231)

1 HYRJE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kolegji si organi i vetëm gjyqësor, gjatë mandatit të tij 9-vjeçar, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për çështjet e rivlerësimit, si dhe juridiksion disiplinor, në përputhje me përcaktimet e nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si Kolegji i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë.

Misioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është: *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.* Kolegji i Posaçëm i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor, me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”.

Përshkrimi i programit: *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”.*

Qëllimi i politikës së programit: *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Objektivi 1 - *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”.*

Treguesi i performancës, i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektivi, është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuara”.*

Për përmbushjen e misionit të tij për vitin 2026, Kolegji ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 87, datë 12.12.2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument përfaqëson Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar, që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apelimit (Kolegji), duke ofruar informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026. Monitorimi i zbatimit të buxhetit për këtë periudhë përfaqëson procesin e vlerësimit të

performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Me qëllim për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu edhe në monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2026

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, ku në total rezulton të jetë miratuar si plan fillestar një vlerë prej 242.6 milionë lekë. Këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 02, datë 15.01.2026, për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2026. Në kërkesat buxhetore për vitin 2026, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përcaktuar si produkt kryesor për realizimin e objektivit: “Të shqyrtojë çështjet e ankimuar nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”. Aktualisht, për 4-mujorin e parë të vitit 2026 janë realizuar 25 çështje, duke përmbyllur në këtë mënyrë shqyrtimin e të gjithë çështjeve. Situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë:

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

Në mijë lekë

<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Fakt 2025</i>	<i>Buxhet vjetor fillestar 2026 sipas ligjit nr. 87/2025</i>	<i>Buxhet vjetor i rishikuar 2026</i>	<i>Buxheti 4-mujor 2026</i>	<i>Fakt 4-mujori i parë i vitit 2026</i>	<i>Në % mbi buxhetin vjetor</i>	<i>Në % mbi buxhetin 4-mujor</i>
600	Paga	233,676	163,734	163,734	84,670	81,804	50%	97%
601	Sigurime Shoqërore	21,902	17,936	17,936	8,700	8,022	45%	92%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	20,777	14,640	14,040	10,500	2,878	20%	27%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	998	46,250	46,850	850	368	1%	43%

230/ 231	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	890	0	0	0	0	0%	0%
Total		278,244	242,560	242,560	104,720	93,072	38%	89%

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA KUNDREJT REALIZIMIT

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit vjetor të Kolegjit, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga të personelit”, me rreth 68%, llogaria “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, me rreth 7%, më pas llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera”, me rreth 6%, ndërkohë që llogaria “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” zë një peshë rreth 19%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës së Kolegjit. Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për periudhën e 4-mujorit të parë të vitin 2026.

Gjatë 4-mujorit të parë të vitin 2026 është synuar përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në vijim synohet konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit, me qëllim realizimin e treguesve të performancës.

2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Buxheti i miratuar sipas ligjit nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, është 242.6 milionë lekë dhe gjatë 4-mujorit të parë nuk ka pasur ndryshime në buxhetin e miratuar, por vetëm rialokim të fondit prej 600,000 lekë nga artikulli 602 – “Shpenzime operative”, tek artikulli 606 – “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, si më poshtë:

- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 1830/1, datë 16.02.2026, protokolluar në Kolegj me nr. 134/1 prot., datë 17.02.2026.

Rishikimi i fondeve buxhetore

Në mijë lekë

<i>Llog. ekonomike</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani fillestar (ligji nr. 87/2025)</i>	<i>Rialokim për shpenzimet celulare</i>	<i>Plan i rishikuar</i>
600	Paga	163,734	0	163,734
601	Sigurime Shoqërore	17,936	0	17,936

602	Mallra dhe Shërbime të tjera	14,640	-600	14,040
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	46,250	600	46,850
Total		242,560	0	242,560

ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, kanë qenë në vlerën 163.7 milionë lekë, ndërkohë që plani për 4-mujorin e parë është 84,6 milionë lekë dhe nuk ka pasur rishikim të planit buxhetor për këtë periudhë. Brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në vlerën 81.8 milion lekë ose në masën 97 % të planit 4-mujor. Ky buxhet është përdorur gjatë 4-mujorit të parë të vitin 2026 për mbulimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për Gjqqtarët, Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe punonjësit administrativë të Kolegjit.

Numri i punonjësve në organikë, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar, është 67 punonjës, ndërkohë që numri mesatar faktik i punonjësve për 4-mujorin e parë të vitit 2026, është 65 punonjës.

Me VKM-në nr. 10, datë 15.01.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”, u miratua një numër shtesë prej 3 punonjësish me kontratë të përkohshme, për një periudhë 6 mujore (8 orë/ditë).

2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, janë në vlerën 17.9 milionë lekë dhe për 4-mujorin e parë të vitit 2026 janë në vlerën 8.7 milionë lekë. Nuk ka pasur rishikim të planit buxhetor për 4-mujorin e parë të vitit 2026. Ky buxhet është realizuar në vlerën 8 milionë lekë ose 45% e planit të vitit 2026, ndërkohë që brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në masën 92% të planit 4-mujor. Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe, si rrjedhojë, argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejné edhe për këtë zë buxhetor.

2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për materiale dhe shërbime të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë operacionale. Shpenzimet për këtë zë zënë 6% të shpenzimeve totale vjetore. Fondet e miratuara në fillim të periudhës për këtë zë, me ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, kanë qenë në vlerën e 14.6 milionë lekë dhe për 4-mujorin e parë, 10.5 milionë lekë. Rishikimet e buxhetit në këtë zë konsistojnë në:

- Transferimin e një fondi në vlerë 600 mijë lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferita për buxhetet familjare dhe individët”, për mbulimin e shpenzimeve telefonike, për kontratat individuale të Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020, dhe në Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për vitin 2026, është realizuar në vlerën 2.9 milionë lekë nga 14 milionë lekë të planifikuara, ose në masën 20% të planit vjetor, ndërkohë që brenda periudhës 4-mujore, buxheti është realizuar në masën 27% të planit 4-mujor.

Nga analizat e kryera nga Kolegji, fondi i miratuar me ligjin vjetor të buxhetit do të realizohet në masën 100%.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

<i>N/artik.</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor 2026</i>	<i>Fakt progresiv 4-mujor</i>
602	<i>Mallra dhe shërbime të tjera</i>	14,040	2,878
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	960	562
2	Materiale dhe shërbime speciale	400	56
3	Shërbime nga të tretë	2,390	1,276
4	Shpenzime transporti	315	152
5	Shpenzime udhëtimi	800	613
6	Mirëmbajtje të zakonshme	600	155
7	Shpenzime për qiramarrje	120	54
8	Shpenzime të tjera operative	8,455	10

Gjatë periudhës 4-mujore janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet bazuar në kontratat dhe faturat, sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike, ujë, shërbime postare, si dhe taksa blerje karburanti, shlyerja e detyrimeve kontraktuale, prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

2.1.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale për: kancelari, materiale higjieno-sanitare, materiale elektrike dhe artikuj si këto. Plani vjetor i buxhetit i miratuar për këtë zë, është 960 mijë lekë, nga i cili është përdorur një fond prej rreth 562 mijë lekë, për të likuiduar faturat për shpenzimet materiale, si: kancelari dhe letër (402 mijë lekë), materiale higjieno-sanitare (131 mijë lekë), Materiale zyre dhe të përgjithshme (30 mijë lekë) etj., të kryera gjatë kësaj periudhe.

2.1.3.2 Materiale dhe shërbime speciale

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me abonimet në shtypin e shkruar (14 mijë lekë), blerje ujë i pijshëm (42 mijë lekë) etj. Nga 400 mijë lekë të planifikuara për vitin 2026, janë përdorur rreth 56 mijë lekë ose 14%. Në këtë zë janë planifikuar fondet për prodhimin e kodekseve për vitet 2024-2026, të cilat pritet të realizohen në muajt në vijim.

2.1.3.3 Shërbime nga të tretë

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet utilitare, si: energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare, telefoni fikse dhe celulare. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri “energji elektrike”, me 625 mijë lekë ose 49% të totalit të tij. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen edhe shpenzimet për shërbimin e printimit, sipas kontratës me nr.605/14 prot., datë 11.06.2025. Realizimi i këtij zëri për 4-mujorin e parë është 293 mijë lekë ose 23% të totalit të fondit në këtë nënartikull. Nga 2,4 milionë lekë të planifikuar, janë realizuar rreth 1,3 milionë lekë ose 54%.

2.1.3.4 Shpenzime transporti

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesët e këmbimit të makinave, goma, bateri, karburant, vend parkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri “parkim për automjetin e institucionit”, në vlerën 85 mijë lekë ose 57%, i realizuar tashmë me lidhjen e kontratës me Bashkinë Tiranë, “karburant”, në vlerën 58 mijë lekë ose 39% të totalit të tij, si dhe është planifikuar një fond për larje automjeti në vlerën 14 mijë lekë. Planifikimi vjetor ka qenë 315 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është në vlerën 152 mijë lekë ose 48%.

2.1.3.5 Shpenzime udhëtimi

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit. Planifikimi vjetor për këtë zë është 800 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është 613 mijë lekë, dhe është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit të drejtuesit të institucionit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Gjithashtu ky fond është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e analizës së punës me temë: “Sfidat e përfundimit të aktivitetit gjyqësor brenda mandatit kushtetues dhe veprimtaria administrative tranzitore deri në dhjetor 2026”.

2.1.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme

Në këtë nënartikull janë planifikuar shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve/pajisjeve TIK, të sistemit elektrik, programit financiar “Financa 5”, si dhe mirëmbajtje të mjeteve të transportit. Buxheti vjetor i planifikuar në këtë zë është 480 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është 155 mijë lekë. Ky fond është përdorur për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së gjeneratorit dhe të faqes web të institucionit.

2.1.3.7 Shpenzime për qiramarrje

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qiranë e ambientit për zhvillimin e analizës së punës me temë: “Sfidat e përfundimit të aktivitetit gjyqësor brenda mandatit kushtetues dhe veprimtaria administrative tranzitore deri në dhjetor 2026”. Plani vjetor për këtë zë shpenzimi ka qenë në vlerën 120 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor është 54 mijë lekë.

2.1.3.8 Shpenzime të tjera operative

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për taksa dhe tatimet të paguara nga institucioni, shpenzime për aktivitete në kuadër të përfundimit të mandatit kushtetues të Kolegjit etj. Për 4 mujorin e parë të vitit 2026 fondet për këtë nënartikull janë përdorur për pagesën e taksave vendore në vlerën 10 mijë lekë.

2.1.3.9 Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria ekonomike 606)

Buxheti vjetor i detajuar në këtë zë është në vlerën 600 mijë lekë dhe realizimi 4-mujor në vlerën 368 mijë lekë ose 43%. Në këtë grup përfshihet fondi për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për Gjyqtarët, Këshilltarët e Kolegjit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe dy Drejtorë Drejtorie, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 1830/1, datë 16.02.2026, protokolluar në Kolegj me nr. 134/1 prot., datë 17.02.2026, nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve, sipas përcaktimit në VKM-në nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 338 mijë lekë dhe dëmshpërblim në rast fatëkeqësie (vdekje pjestar i familjes) në vlerën 30 mijë lekë. Fondet e planifikuara në këtë nënartikull do të mbulojnë shpenzimet për rimbursim të shpenzimeve të telefonisë celulare deri në datën 29.05.2026 , kur përfundon edhe kontrata nr.127 prot., datë 16.02.2026.

2.1.4 Shpenzimet kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligjin 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, nuk ka fonde në investime.

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, për 4-mujorin e parë të vitit 2026.

Nëpunës Zbatues

Nëpunës Autorizues